

VENDIM
Nr. 375, datë 20.5.2026

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË PYJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të kreut III, të vendimit nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e znj. Rudina Hoxha në detyrën e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu